

VENDIM
Nr. 30/2014

PËR VENDIMMARRJEN E KUVENDIT, LIDHUR ME INSTITUCIONIN E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL DHE ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, neni 12 i tij, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mbarimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Shërbimit Civil (krijuar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”).

II. Qëndrimin në detyrë të Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil deri në miratimin e strukturës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

III. Fillimin e procedurave për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përmes një procesi të hapur publik, konsensual, transparent dhe gjithëpërfshirës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.5.2014